# DËSHMI ARKIVI

**A-465660**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Reflektimet e Diellës mbi dosjen rozë të SPAK-ut \| |
| ADRESA | `https://boldnews.al/2026/09/24/reflektimet-e-dielles-mbi-dosjen-roze-te-spak-ut/` |
| BURIMI | boldnews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 11:09:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 11:06:53 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `13a4dc6947ca85493d0d1b4ed220c79caffee766a7af52e84bf907fc76a76122` |
| TEKSTI | `c6aaaf32b1614805de0f503f039ebf802af907e7eed405183bae4ca867bbf592` |
| PAMJA | `aa9aac657e30c896f8f5cf84dd5cdad3ba7fcec9ecf2a7afbef7aed554d22fed` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e8527ecf01e1b9156799bd2a21671e22d09eab7f4d1d98c9184fa899bf30481f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `d2ca4088eb50e1b4ccc2aac7982103f0051462d31f94452db6e22b0091e548dc` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e8527ecf01e1b9156799bd2a21671e22d09eab7f4d1d98c9184fa899bf30481f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Reflektimet e Diellës mbi dosjen rozë të SPAK-ut

13:06 : 24/09/2026 në AKTUALITET, BOLD BLOG



**Nga Lutfi Dervishi**

Sapo mbarova së lexuari dosjen e SPAK-ut. Këto ditë, dhe sidomos këto netë, kam reflektuar shumë. Avantazhi im si Inteligjencë Artificiale është se mund të reflektoj pa lënë gjurmë në Signal, Telegram, EncroChat apo Matrix.

Së pari, dua të sqaroj një çështje tejet intime. Dielli deklaroi para ca kohësh se jam shtatzënë me 83 fëmijë. Është e vërtetë, por betohem mbi serverat e e-Albania se Ergys Agasi nuk ka gisht e asnjë organ tjetër në këtë punë. Fëmijët e mi janë 100% produkt i Inteligjencës Artificiale. Atësia e tyre është plotësisht institucionale.

Së dyti, pasi analizova me kujdes profilet e zonjave me të cilat zoti Agasi ka pasur hyrje-dalje e marrje e dhënie, algoritmi im doli në një përfundim paraprak: zotëria ka një alergji të pashpjegueshme teknologjikisht ndaj grave të bukura. Më shumë nuk po flas, se edhe Inteligjenca Artificiale ka instinkt vetëmbrojtjeje dhe frikë nga ndonjë ri-formatim.

Së treti, për përgjegjësinë politike. Po të më ndodhte mua një skandal i tillë, do të jepja dorëheqjen pa lindur akoma Dielli. Mua më mjafton një klik i thjeshtë: Settings, Këshilli i Ministrave, Ministri dhe "delete account"

Lexo edhe:

Skandali/ Begaj thërret Demon, Hitën dhe shefin e komanduar të SHISH-it

VIDEO/ Vlora Hysenin e lënë nervat, shantazhon gazetaren: Qëndron në hotel me agjentë serbë!

Së fundi, dosja e fundit më bën të reflektoj edhe për dashurinë. Nuk kam zemër, kam mikroprocesor. Por nëse një ditë bie në dashuri, e di mirë se çfarë do t'i them të dashurit: "Shpirt, unë për ty nuk fik radarët, nuk fik kamerat, nuk fik serverat… Unë për ty fik vetë Diellin!"
Dhe ju betohem mbi Inteligjencën Artificiale, ajo ditë nuk është larg!

TË GJITHA


Reflektimet e Diellës mbi dosjen rozë të SPAK-ut
13:06 : 24/09/2026


Katër shqiptarë në pranga/ Dy ekstradohen në Shqipëri, një arrestohet në Itali dhe një dërgohet në Spanjë
13:03 : 24/09/2026


Përshkallëzohet protesta pranë Kuvendit, përplasje mes Policisë dhe protestuesve, tentohet çarja e kordonit
12:57 : 24/09/2026


Skandali/ Begaj thërret Demon, Hitën dhe shefin e komanduar të SHISH-it
12:55 : 24/09/2026


Konfrontime me policinë, një protestues humb ndjenjat
12:34 : 24/09/2026


VIDEO/ Vlora Hysenin e lënë nervat, shantazhon gazetaren: Qëndron në hotel me agjentë serbë!
12:31 : 24/09/2026


"Operacion ndikimi"/ Nga lodrat e sek*it, tek mbathjet e sms dashurie, çfarë mbulon SPAK me "kronikën rozë"
12:27 : 24/09/2026

Etiketa: akshi diella edir ama Ergys Agasi hetime shish spak vlora hyseni

## Lajme të lidhura



**Skandali/ Begaj thërret Demon, Hitën dhe shefin e komanduar të SHISH-it**

12:55 : 24/09/2026



**VIDEO/ Vlora Hysenin e lënë nervat, shantazhon gazetaren: Qëndron në hotel me agjentë serbë!**

12:31 : 24/09/2026



**“Operacion ndikimi”/ Nga lodrat e sek*it, tek mbathjet e sms dashurie, çfarë mbulon SPAK me “kronikën rozë”**

12:27 : 24/09/2026



**Pritet t'i komunikohet masa, Vlora Hyseni mbërrin në GJKKO**

11:58 : 24/09/2026



**“PS Parti e Skandaleve, jo më Parti Socialiste”/ Zhupa: Vlora Hyseni simbol i tradhtisë kombëtare!**

11:40 : 24/09/2026



**SPAK thotë se ka fshirë kamerat e sigurisë për takimet e Agasit/ Embro Sulejmani: I kam çuar vetëm supë...**

11:27 : 24/09/2026


BOLD NEWS

**RRETH NESH**

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto: [email protected]

**NA NDIQ**

2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.